



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi 7 dhe në lidhje me nenit 77 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 12/2019) dhe nenit 40 paragrafi 4 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit (teksti i pastruar) duke vepruar pas denoncimit, në seancën e 42-të, të mbajtur me datë 11.12.2020, morri

## VENDIM

Në procedurë të inicuar nga detyra zyrtare nga ana e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit është vërtetuar se personi zyrtar ..... – zëvendës-kryetar i Qeverisë së RMV, në periudhën e caktuar ligjore pas zgjedhjes së funksionit nuk dorëzoi listë anketuese dhe deklaratë për interesat e Komisionit shtetëror, gjë që është në kundërshtim me nenin 82 paragrafi 1 dhe 3 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave.

Komisioni shtetëror në përputhje me përgjegjësitë e veta të parapara në nenin 109 paragrafi 1 pika 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, ngriti procedure kundërvajtje kundër personit ..... – zëvendës-kryetar i Qeverisë së RMV, dhe ai dorëzoi dëshmi për pagesën e realizuar të dënimit për kundërvajtje.

Veprimi për lëndën me numër 09-3867/1 me datë 11.11.2020 **NDËRPTITET** dhe e njëjta të mbyllet dhe të arkivohet.

## Sqarim

Lënda me numër 09-3867/1 me datë 11.11.2020 është formuar me iniciativë të veten, në përputhje me nenin 12 paragrafi 1 pika 10 dhe 12 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, sipas të cilit Komisioni shtetëror e evidentoi gjendjen vijuese të pronës dhe interesave dhe bëri kontrollim të të dhënave nga deklaratata për gjendjen e pronës dhe interesave.

Komisioni shtetëror pas inspektimit të bërë në evidencën e vet, konstatoi se personi ..... – zëvendës-kryetar i Qeverisë së RMV është zgjedhur në funksionin që e kryen nga data 30.08.2020, dhe me atë nuk ka plotësuar obligimin ligjor të paraparë në nenin 82 paragrafi 1 dhe 3 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave.

## Neni 82

*(1). Personi i zgjedhur ose i emëruar, personi përgjegjës në ndërmarje publike, objekt publik ose person juridik tjetër që disponon me kapital shtetëror, noter, përmbarues, zyrtar administrativ nga kategorija A të caktuar me ligj ose person i punësuar në kabinetin e kryetarit të Republikës së Maqedonisë, Kryetari i Parlamentit të Republikës së Maqedonisë, nën-kryetarët e parlamentit të Republikës së Maqedonisë, Kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, zëvendësit e kryetarit të Republikës së Maqedonisë, përshkak se bëjnë detyra të punës të kësilltarit të veçantë, emërimi, gjegjësisht punësimi, dhe më së voni në periudhë prej 30 ditësh pas zgjedhjes, emërimit, gjegjësisht punësimit dorëzoi deklaratë për gjendjen e pronës dhe interesave.*

(3). *Personi nga paragrafi 1 të këtij ligji ka detyrë që të dorëzon deklaratë për gjendjen e pronës dhe interesave dhe në periudhë prej 30 ditësh nga dita e marrjes së funksionit gjegjësisht punësimit.*

Pas konstatimit të këtillë të gjendjes së pronës, Komisioni shtetëror deri tek personi ..... dërgoi fletëpagesë për kundërvajtje dhe e informoi për kundërvajtjen e bërë dhe për atë është i obliguar ta bënë pagesën e gjobës në vlerën e theksuar në fletëpagesën për kundërvajtje në periudhë prej 8 ditësh nga dita e pranimit të fletëpagesë për kundërvajtje në llogari të theksuar në fletëpagesën për kundërvajtje dhe menjëherë të dërgon fakte për pagesën e bërë deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, rr. "Dame Gruev" nr. 1, 1000 Shkup, dhe në kundërshtim të kësaj person zyrtar i autorizuar i Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit do të dorëzon kërkesë për procedurë për kundërvajtje deri tek Komisioni për kundërvajtje në Komisionin shtetëror.

Duke pasë parasyshë të lartëshënuarën, si dhe veprimet të ndërmarra nga ana e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, gjegjësisht procedura e ngritur për kundërvajtje përshtak të konstatimit të kundërvajtjes dhe veprimeve të ndërmarra nga ana e personit zyrtar, gjegjësisht fakteve për realizimin e pagesës, Komisioni shtetëror në seancën e katërdhjetë e dytë vendosi në bazë të dispozitave të këtij vendimi.

Punoi: M-r Ema Neshkoska, bashkëpuntorë  
Miratoi: Sofka P. Dojçinovska

**КОМИСИОНИ ШТЕТЁРОР ПЁР  
ПАРАНДАЛИМ ТЁ  
КОРРУПСИОНИТ  
Kryetarë: Biljana Ivanovska**